

## Si të mbrohem nga vjedhja e identitetit?

Banka ProCredit është përkushtuar në atë që t'i bëjë transaksionet tuaja online më të sigurta si edhe ta mbrojë integritetin e të dhënave në llogarinë tuaj bankare. Me qëllim që ta arrijmë këtë, e shfrytëzojmë softuerin më të ri të sigurisë dhe zbatojmë shumë procedura sigurie. Megjithatë, çdoherë duhet të keni në mendje se Interneti dhe posta elektronike mund të shfrytëzohen si mjete për aktivitet jolegal. Prandaj, rekomandojmë që të ndërmeren disa masa të thjeshta për kujdes që të vërtetoheni në sigurinë tuaj kur kryeni punë bankare online.

### Këshilla që të mënjanoni vjedhjen e identitetit

#### Çka është “vjedhja e identitetit”?

Vjedhja e identitetit është përpjekje për të pasur qasje deri te informatat e ndjeshme personale nëpërmjet dërgimit të postës elektronike e cila gjoja vjen nga ndërmarrja e vërtetë e cila punon në Internet, por faktikisht, ajo është faqe e rejshe e internetit, e drejtuar nga ana e mashtruesve.

#### Çfarë informata do të kërkojnë ata nga unë?

Posta e rrejshe elektronike zakonisht pohon që është e domosdoshme t'i “azhurnoni” ose t'i “verifikoni” informatat në profilin tuaj dhe kërkojnë nga pranuesi të klikojnë në ndonjë lidhje në postën elektronike e cila çon deri te faqja e rrejshe e internetit. Të gjitha informatat të cilat janë bartur në atë faqe të internetit merren nga ana e kriminelëve me qëllim të mashtrimit.

#### Si t'i iki mundësisë që të bëhem viktimë e vjedhjes së identitetit?

Çelësi që të jeni të sigurt është të dyshoni në lidhje me të gjitha mesazhet elektronike të padëshiruara ose të papritura që i fitoni, bile edhe nëse duken se janë nga burim i besueshëm. Mesazhet elektronike dërgohen me pritje se do të arrijnë deri te adresa aktive e postës elektronike e cila i takon klientit me llogari në institucionin i cili synohet.

#### Çka të bëj nëse pranoj postë elektronike për vjedhjen e identitetit?

Nëse pranoni postë elektronike të dyshimtë, ju lutemi menjëherë lajmërojeni Bankën ProCredit me atë që do ta vizitoni degën më të afërt, do të kontaktoni me Këshilltarin Tuaj për klientë ose do të lajmëroheni në numrin vijues: **02 2446-000** Gjithashtu mund ta ridërgoni letrën elektronike në adresën vijuese: **info@procreditbank.com.mk**.


**Për më tepër informata, vizitoni faqe të specializuara të internetit si:**

<http://www.staysafeonline.org/stay-safe-online/keep-a-clean-machine/spam-and-phishing>

## **Këshilla plotësuese për siguri online**

**Si ta vërej postën elektronike për vjedhje të identitetit?**

Posta elektronike për vjedhjen e identitetit mund të duket sikur është dërguar nga adresa zyrtare e postës elektronike të Bankës ProCredit. Për fat të keq, është relativisht e lehtë për vjedhësit e identitetit që të bëhet hyrje e rrejshme në fushën “Nga” ose ta mbulojnë destinacionin përfundimtar të lidhjes.



Shembull: postë e rrejshme elektronike

Edhe pse Banka ProCredit mund të ju kontaktojë nëpërmjet postës elektronike, posta elektronike asnjëherë nuk do të përmbajë lidhje e cila do t'ju dërgojë deri te faqja e internetit e cila nga ju do të kërkojë informata personale (fjalëkalim, kod për token, SMS me numër për verifikim të transaksionit etj.).

**Mos u bëni plotësisht të besueshëm për çfarëdo ndryshimi në rutinën tuaj të zakonshme për shërbime bankare në internet. Nëse keni çfarëdo dyshimi, ju lutemi kontaktojeni Bankën ProCredit duke e vizituar degën më të afërt, ose kontaktojeni Këshilltarin tuaj të Klientëve ose thirrni në linjën tonë për ndihmë në 02 2446-000.**